



“Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENIOR-A “Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze”
Nr. 12 Viti i dytë i botimit Maj 2014

Ditari Naturës

Në këtë numër do të gjeni:

- Eficienca e Energjisë në Parkun Themistokli Gërmenji në Korçë.
- Strategjia e Komunikimit në Projektin e SEA-Med.
- WWF nënshkruan me grupet lokale të interesit Marëveshjen për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në Valbonë.
- Parku Natyror Rajonal i Ulzës promovon turizmin.
- Unique Yew Hedge to be created from Historic and Threatened Trees World-wide.
- Njoftime.

Eficienca e Energjisë në Parkun Themistokli Gërmenji në Korçë

Korçë, 15 Prill 2014

Në kuadër të përmblylljes së aktiviteteve të projektit “Eficienca e Energjisë për sistemin e ndriçimit në Parkun Themistokli Gërmenji”, i financuar nga GEF-SGP dhe Bashkia Korçë, si dhe i zbatuar nga INCA (Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri) dhe

Bashkia Korçë, u organizuan disa aktivitete sensibilisuese përmblylëse. Financimi bëri të mundur ndriçimin me llamba LED të dy Parqeve kryesore të qytetit të Korçës, Parkun Themistokli Gërmenj dhe Parkun Vangjush Mio. Aktivitetet filluan në ambientet e Parkut “Themistokli Gërmenji” me nxënësit e shkollave të cilët



zhvilluan fushata sensibilizuese mbi eficiencën e energjisë. Ata shpërndanë informacione mbi eficiencën e energjisë dhe ndriçuesit e rinj tek personat e rastësishëm në park si dhe shpërndanë fletëpalosje dhe vendosën postera të përgatitur nga vetë ata për këtë qëllim. Më pas me pjesëmarrjen autoriteteve lokale, të Prefektit të Qarkut Z. Ardit Konomi, Kryetarit të Bashkisë Z. Sotiraq Filo, Koordinatorit Lokal të GEF-SGP Z. Arjan Gaçe, të Presidentit të INCA-s Z. Zamir Dedej, u zhvillua

Vijon në faqe 2



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri



Vijon nga faqe 1

ceremonia inaguruese e ndriçimit me llamba LED e kësaj lulishte. Në mënyrë simbolike, sapo kishte rënë pak muzgu, u ndezën dritat në këtë Park. Në ceremoni merrnin pjesë përfaqësues të Prefekturës dhe Bashkisë Korçë, përfaqësues të OJF-ve të qytetit të Korçës, nxënës të shkollave, qytetarë, etj.

Projekti "Eficienca e Energjisë për sistemin e ndriçimit në Parkun Themistokli Gërmenji", i cili u financua nga GEF-SGP dhe Bashkia Korçë, ka patur për qëllim jo vetëm të kontribuojë për efikasitetin e energjisë në vend duke instaluar teknologjinë më të re, atë të përdorimit të llabave LED, por të sigurojë qasje të re, të krijojë një model për tu ndjekur edhe për pjesë të tjera të ndriçimit publik. Përdorimi i llabave LED në ndriçimin publik është një mënyrë alternative që çon në reduktimin e konsumit të energjisë. INCA,

organizata zbatuese e projektit në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës bënë të mundur instalimin e 35 shtyllave në të dy Parqet e qytetit, së bashku me ndriçuesit në një afat shumë të shkurtër kohor.

Me anë të këtij projekti u realizua një investim direkt në përmirësimin e ndriçimit të parqeve duke implementuar teknologjinë e re të instalimit të ndriçuesve LED.

Zbatimi i një sistemi të ri ndriçimi në këto parqe do të sigurojë një cilësi më të mirë dhe do të promovojë një mënyrë të re të mbrojtjes së

natyrës me teknologji miqësore ndaj mjedisit. Llambat LED që u instaluan do të reduktojnë konsumin e energjisë dhe emisionet e CO2 në atmosferë duke krijuar një mjedis miqësor dhe më të shëndetshëm.

Strategjia e Komunikimit në Projektin e SEA-Med.

Vlorë 22-23 Prill 2014

Në kuadër të projektit "Aktivitetet qëndrueshme ekonomike në Zonat e Mbrojtura Detare të Mesdheut - Shqipëria" u zhvillua trainimi me temë "Strategjia e Komunikimit". Qëllimi i këtij trajnimi 2 ditor ishte për të përcaktuar çështjet kyçe të strategjisë së komunikimit, audiencën e synuar, hartat udhëzuese në komunikim dhe arsim dhe të gjitha elementeve të tjera kryesore të nevojshme për hartimin e strategjisë për komunikim. Seminari u drejtua nga ekspertia ndërkombëtare Corinne Brunois me pjesëmarrjen e ekipit bërthamë të projektit, oficerët e komunikimit të INCA dhe PPNEA, eksperti vendor i komunikimit, koordinatori lokal i projektit në Vlorë, pjesë e ekipit të planifikimit të themeluar për këtë

projektit.

Seminari u organizua në mënyrë interaktive. Strategjia e komunikimit e projektit SEA-Med do të zhvillohet nga stafi i INCA në bashkëpunim me ekspertin lokal të komunikimit dhe do të zbatohet këtë verë nga eksperti në kuadër të projektit nga INCA. Eksperti lokal i komunikimit ka një përvojë të gjatë në arsim dhe ka një gamë të gjerë të vullnetarësh për mjedisin të cilët do të angazhohen në mënyrë aktive gjatë sezonit të verës për të vënë në jetë strategjinë. Prania e ekipit PPNEA në këtë trainim konsiderohet si një mundësi madhe për të filluar bashkëpunimin me projektin që po zhvillon PPNEA "Vëndi i shqiptonjave dhe kështjellave".



WWF nënshkruan me grupet lokale të interesit Marrëveshjen për Zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në Valbonë.

Lugina e Valbonës, 24 Prill 2014

Nën peisazhin malor të Parkut Kombëtar “Lugina e Valbonës” u nënshkrua sot Marrëveshja për zhvillimin e turizmit midis përfaqësuesve të WWF Mesdhe, Ministrisë së Mjedisit, qeverisjes lokale,

shërbimeve të mikpritjes dhe komunitetit të zonës. Ky angazhim nënkupton që Parku i Valbonës do të ndërtojë në vitet në vijim, standarte të

turizmit që njohin dhe ruajnë vlerat e natyrës, respektojnë traditat kulturore të vendit, promovojnë prodhimet lokale, duke i dhënë njëkohesisht asaj njohjen ndërkombëtare që i takon si destinacion elitare. Marrëveshja e sotme u arrit pas 6 muaj pune

përgatitore të projektit Parqet Dinarike të Shqipërisë dhe u nënshkrua në prezencën e më shumë se 40 pjesëmarrësve nga komuniteti i


zonës, gazetarë të mediave qendrore e lokale.

“Ky është një moment i rëndësishëm për të ardhmen e trashëgimisë natyrore të zonës Valbonë- tha Andrea Stefan, përfaqësuese e WWF - “Marrëveshja e WWF me grupet lokale të interesit shënon fillimin e procesit që do të vendosë Valbonën në hartën e parqeve europiane më të vizituar. Certifikimi si park europian me turizëm të qëndrueshëm është mjet i shkëlqyer për promovimin e turizmit dhe zhvillimin e ekonomisë së zonës. Kështu njerëzit dhe natyra

punojnë së bashku për të bërë më të mirën për Valbonën”.

Ndërsa përfaqësuesit e qeverisjes lokale ishin entuziastë për të ardhmen e kësaj iniciative. “Ne jemi krenarë t’ju tregojmë turistëve bukuritë e Valbonës

sonë. Por mbi të gjitha duam që vizitorët e huaj dhe vendas të njohin mikpritjen e malësorit dhe thesaret e kulturës sonë. Me anë të çertifikimit të Parkut Valbonë ne synojmë të promovojmë produktet ushqimore dhe artizanale të zonës si markat tona lokale” – u shpreh Rexhë Biberaj, Kryetar i Komunës Margegaj.



Ekspertët e WWF dhe INCA (Instituti për Ruajtjen e Natyrës Shqipëri) do të mbështesin grupet e interesit të zonës Valbonë drejt ngritjes së një modeli të ri turizmi në parqet kombëtare

që mund të ndiqet në të ardhmen nga 14 parqet e tjera të Shqipërisë. Puna e përbashkët në një forum të përhershëm të aktorëve lokalë dhe përgatitja e një strategjie zhvillimi janë dy prej kriterëve më të rëndësishme në procesin e aplikimit për çertifikim. Në përpjekje për t’a

bërë rajonin e Parqeve Dinarike një markë turistike tërheqëse për turistët e huaj, WWF po mbështet në të njëjtën mënyrë 16 parqe të rajonit të Ballkanit

Perëndimor drejt anëtarësimit në Federatën Europiane të Parqeve.

Parku Natyror Rajonal i Ulzës promovon turizmin.

Ulzë, 25 Prill 2014

Me Vendimin Nr.16, datë 03.04.2013, Këshilli i Qarkut Diber shpalli liqenin e Ulzës dhe zonën përreth tij si "Park Natyror Rajonal", si i pari Park i këtij lloji në vendin tonë, mbështetur në ligjin e Zonave të Mbrojtura (nr.8906, datë 06.06.2002 dhe amendimi i tij) dhe VKM-në nr.519, datë 30.06.2000. Parku zë një sipërfaqe prej 4.206 ha dhe mbulon zonën nga diga e hidroçentralit të Shkopetit përgjatë shpateve e kreshtave të kodrave përgjatë kufirit ndarës me rrethin e Mirditës dhe të gjithë territorin e liqenit të Ulzës. Ky Park është shpallur falë punës së Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) në bashkëpunim me Komunën Ulzë, dhe mbështetjes e përkrahjes së Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe stafit të Ministrisë së Mjedisit.

Me rastin e një vjetorit të shpalljes së Parkut Natyror Rajonal në Shqipëri, si edhe festimeve të ditës së Shën Markut, një prej festave tradicionale të qytezës së Ulzës, Rrjeti i organizatave për Mbrojtjen e Natyrës, veçanërisht të shoqatës Miqësia-Ulzë dhe INCA, në bashkëpunim me Komunën Ulzë organizuan ditën e Premte, datë 25 Prill 2014 në Komunën Ulzë një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe promovuese. Në aktivitete pati një pjesmarje të madhe nga komuniteti i zonës së Ulzës dhe atij përreth tij, përfshirë edhe nxënësit e shkollave, duke krijuar një ambjent festiv të këndshëm.

Qëllimi i festimit ishte të afroje komunitetin pranë zonës së mbrojtur, duke e bërë sa më të dukshme këtë territor të mbrojtur me ligj, por nga ana tjetër që nëpërmjet festave lokale të promovojë vlerat turistike të zonës të cilat janë me të vërtetë unike. Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në këtë zonë do të ketë impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë lokale, por nga ana tjetër përçon më mirë principe të mbrojtjes së natyrës. Gjithashtu duke parë specifikën e zonës po tentohet të promovohet turizmi i sporteve ujore, duke krijuar mundësinë e shetitjes me barkat e peshkatarëve dhe ato me kanoa, si një risi më shumë për këtë zonë që ende nuk është shfrytëzuar.

Parku Natyror Rajonal i Ulzës përbën

shëmbullin e parë në vendin tonë të kësaj përfaqje të re për të sjellë zonat e mbrojtura më afër komunitetit dhe autoriteve vendore dhe duke kontribuar në mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës biodiversitetit në vend. Ky park kërkon të promovojë vlerat e biodiversiteti që kjo zonë strehon, të ruajë e të mbrojë natyrën e bukur që ka zona, të rrisë interesin për zhvillimin e turizmit dhe të sjellë në vëmendjen e çdo vizitori mundësinë e argetimit dhe kënaqesinë dhe pse jo, të bëhet shëmbull dhe promotor për shpalljen e parqeve të tjerë natyror rajonal në Shqipëri.



Unique Yew Hedge to be created from Historic and Threatened Trees World-wide.

Young plants propagated from ancient and threatened yew trees collected from around the world are being used to create a unique heritage hedge and important conservation resource in Scotland, at the Royal Botanic Garden Edinburgh (RBGE).

The hedge is being created using 2,000 small trees from the common yew (*Taxus baccata*). Planted around the perimeter of the Garden, it will cover a kilometer in length and take an estimated 10 years to complete.

Around 80 per cent of the hedge will comprise of plants grown from populations worldwide where the *Taxus* genus is listed nationally as threatened. These range from the Czech Republic, Albania and Croatia to Norway – which has the northernmost natural population of *Taxus baccata* in the world - Sweden and Denmark. Seed collections have also come from the threatened population in Sochi National Park in Russia as well and old-growth trees of some 1500 years in age from Crimea.

Other represented countries are Hungary, Estonia and Georgia, where some protected slopes in the Borjomi-Kharagauli National Park were destroyed by the Russian Air force during the 2008 conflict.


RBGE also has plants propagated from famous heritage trees around Britain and Ireland. At the heart of the project are progenies of the most ancient of all, the Fortingall yew which stands in Aberfeldy, Perthshire. Estimated to be 3,000 years old, it is thought to be the oldest living tree in the UK, if not in Europe.

The Royal Botanic Garden Edinburgh's Martin Gardner, Co-ordinator of its International Conifer Conservation Programme, says: "This is the first time that a botanic garden will be surrounded by a

conservation hedge and it is of great importance. There is a need to conserve old-growth trees and remnant populations, and to safe-guard plant biodiversity in the face of global environmental change.

"Once the hedge is established, I look forward to being asked why the yew hedge is not uniform in growth, colour and texture. My response will simply be 'Ah, but that is biodiversity for you'."

There are many well-documented heritage old-growth yew trees to be found in churchyards and stately homes. The common yew has always played an important part in the culture of mankind through folklore, medicine, warfare and religion and represents a powerful symbol of resurrection.



Martin Gardner - koordinatori i këtij programi, ka vizituar Shqipërinë në vitin 2009. Ai ka bërë një ekspeditë të gjatë në Shqipëri me qëllim të mbledhjes së materialeve të gjalla bimore, sidomos të drurëve halorë, midis të cilave edhe fara tisi (*Taxus baccata*), të popullatës që haset në Llogara.

EDITOR'S NOTES

For further information, images and interviews, please contact: Paula Bushell, Head of Marketing and Communication, at the Royal Botanic Garden Edinburgh on p.bushell@rbge.org.uk or 07866 312545 or Shauna Hay, Press and Marketing Manager on 0131 248 2900 or 07824 529028

Portugal - Central Portugal in the Serra da Estrela, Zêzere valley. The largest naturally-occurring population left in central Portugal estimated to be between 40 and 50 mature individuals. Main threat is fire but some trees have been cut. No regeneration recorded.

Albania - South-east Albania; Llagora. Relatively small population of probably a few hundred trees, most old-growth trees either cut or mutilated. This is now thought to be the only population left in Albania

Norway - Southern Norway; Otterøya island. The northernmost natural population of *Taxus baccata* in the world. The population is reported to contain 23 individuals scattered through a long, narrow strip of forest, of which 13 were identified and sampled for the Yew Conservation Hedge

Sweden - South-eastern Sweden on the island of Öland in the Baltic Sea.

Denmark - South-eastern Denmark at Munkebjerg, south of Vejle Fjord. A small population which is the only known location for *Taxus baccata* in Denmark.

Ukraine - Crimea, Grand Canyon . Old-growth trees of 1500 years old

Russian Federation - Sochi National Park. A very threatened population

Hungary - North-west Hungary in the Bakony Mountains. Population of 120,00 trees which is considered to be the largest in central Europe

Croatia - Požega; Papuk mountain. Two very small populations

Estonia - Hiiumaa Island; Extreme on the Takhuna Peninsula and within the Takhuna Nature Reserve (forming part of the Hiiumaa Biosphere Reserve). Population ca 400 mature trees covering an area of ca 50 km², Total population in Estonia thought to be about 2000 mature individuals.

Georgia - Borjomi-Kharagauli National Park. Although within the protected areas of Borjomi-Kharagauli National Park, parts of these forested slopes have been destroyed by the Russian Air force during the 2008 conflict

The Royal Botanic Garden Edinburgh (RBGE) is a leading international research organization delivering knowledge, education and plant conservation action in more than 80 countries around the world. In Scotland its four Gardens at Edinburgh, Benmore, Dawyck and Logan attract nearly a million visitors each year. It operates as a Non Departmental Public Body established under the National Heritage (Scotland) Act 1985, principally funded by the Scottish Government. It is also a registered charity, managed by a Board of Trustees appointed by Ministers. Its mission is “exploring and explaining the world of plants for a better future.” Learn more: www.rbge.org.uk

NJOFTIME

- 1- Mediterranean Initiative Bulletin is now online.
http://wwf.panda.org/what_we_do/where_we_work/mediterranean/mediterranean_initiative_bulletin/mibulletin_issue4/
- 2- IUCN _ Bulletin https://cmsdata.iucn.org/downloads/iucn_see_e_bulletin_37_spring_2014_.pdf

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

• **Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në buletin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes buletinit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.**

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

• **Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENIOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.**

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro